POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Abuzoi seksualisht me të shoqen dhe u arrestua në 2016, e shkuara në Tiranë e 48-vjeçarit që vrau të dashurën në Athinë
2 Aksidentoi për vdekje drejtuesin e biçikletës në Durrës dy ditë më parë dhe u largua, arrestohet 38-vjeçari! Report Tv siguron foton e viktimës (EMRI)
3 Lajthitë mbeten stok në Fier e Mallakastër, fermerët: Prodhimi është i bollshëm, por çmimi i dobët
4 Ekzekutohet në mes të ditës kriminelei famëkeq në Izrael, vrasësi e qëllon me armë pas koke (VIDEO)
5 Me veshje të pista, duke larë sytë... dalin videot e papublikuara të arrestimit të 'El Chapo': U kam thënë njerëzve të mi të mos më shpëtojnë

Kronikë

# Vrasje e dyfishtë në Mgull të Dukagjinit, humbin jetën babë e bir, plagoset rëndë një tjetër! Në të njëjtën zonë u ekzekutua një muaj më parë Aleksandër Koçeku (EMRAT)

*Sipas informacioneve paraprake, viktimat janë babë e bir, Lekë e Prel Gjoni. I plagosur rëndë ka mbetur Lazer Bashi. Të dhënat paraprake ngrenë hipotezën se mund të bëhet fjalë për gjakmarrje, por rrethanat mbeten ende të paqarta.*

Lajm i fundit/ Vrasje e dyfishtë në Mgull të Dukagjinit, viktimat babë e
Report TV
Watch on

Redaksia
23 Gusht, 17:44 | **Përditesimi: 23 Gusht, 20:00**
Share Post

Një vrasje e dyfishtë me armë zjarri ka ndodhur rreth orës 17:20 të pasdites së sotme në fshatin Mgull të Dukagjinit. Sipas informacioneve paraprake, viktimat janë babë e bir, Lekë e Prel Gjoni. I plagosur rëndë ka mbetur Lazer Bashi, i cili ka mbërritur në spital.

Policia vendore por edhe efektivë të Forcës Kombëtare të Sigurisë janë nisur drejt vendngjarjes, por bëhet fjalë për një zonë të thellë malore dhe komunikimi është i vështirë.

Të dhënat paraprake ngrenë hipotezën se mund të bëhet fjalë për gjakmarrje, por rrethanat mbeten ende të paqarta. Vetëm pak më shumë se një muaj më parë, më 11 korrik, në këtë zonë, në fshatin Kir, ***u vra 40-vjeçari*** Aleksandër Koçeku. Ai u qëllua me breshëri plumbash ndërsa lëvizte nga Kiri drejt Prekalit. Viktima ***ishte në gjak*** pasi vëllai i tij, Artan Koçeku, është në burg për ***vrasjen e Angjelin Shkambit*** në dhjetor 2017.



LEXO EDHE:
**Ekzekutohet në mes të ditës krimineli famëkeq në Izrael, vrasësi e qëllon me armë pas koke (VIDEO)**

**Njoftimi i policisë:**

*Rreth orës 17:20, në fshatin Mgull, Njësia Administrative Pult, Dukagjin, dyshohet se janë vrarë me armë zjarri shtetasit L. Gj. dhe P. Gj., babë e bir, si dhe është plagosur rëndë shtetasi A. P.*

*Forca të shumta të Policisë Vendore dhe të Forcës Kombëtare të Sigurisë, Njësia Shkodër, janë nisur drejt vendngjarjes.*

*Ndërkohë, është ngritur një grup i posaçëm hetimor, i cili po shkon në vendngjarje, për zbardhjen e plotë të rrethanave, dokumentimin ligjor të ngjarjes, si dhe identifikimin dhe kapjen e autorit/autorëve.*

***Informacion shtesë***

*Në vijim të informacionit paraprak të dhënë pak më parë, për ngjarjen në fshatin Mgull, Njësia Administrative Pult, Dukagjin, ku dyshohet se janë vrarë me armë zjarri shtetasit L. Gj. dhe P. Gj., babë e bir, dhe është plagosur një shtetas tjetër, sqarojmë se:*

*Në këto momente ka mbërritur në Spitalin Rajonal Shkodër, për të marrë ndihmë mjekësore, shtetasi i plagosur L. B. dhe jo A. P., siç ju informuam në informacionin paraprak.*

*Me mbërritjen e shërbimeve të Policisë dhe të grupit hetimor në vendngjarje, si dhe pas kryerjes së veprimeve të para hetimore, do t'ju informojmë përsëri.*

*Lajm në përditësim...*

P.J/Shqiptarja.com

**TAG:** Prel Gjoni, Leke Gjoni, Lazer Bashi, dukagjin, Shkoder, vrasje

**Sa e vlerësoni këtë artikull?** 3.7 / 5 (3 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

**Komente**

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016









**Sondazhi i ditës:**
**Si po menaxhohet situata me zjarret?**
23 Gusht, 08:55
Mirë | Keq | Nuk e di

## Lajme të tjera



Shkodra tërheqëse për të huajt që vizitojnë Shqipërinë! Turistët provojnë edhe biçikletat e ujit: Do të rikthehemi
Ergys Kavaja
23 Gusht, 20:53



Report Tv në Gojan të Pukës/ Pas një jave beteje me flakët, fshati i rikthehet qetësisë! Mes dëmeve që la zjarri, banorët rrëfejnë tmerrin: Ishte si luftë
Armir Mehaj
23 Gusht, 12:49



Nga Durrësi në Shkodër për të vjedhur bicikleta dhe grabitur taksi, arrestohet 56-vjeçari
23 Gusht, 11:04



E rëndë në Greqi/ Shqiptari vret të dashurën për xhelozi dhe më pas veten! I zuri pritë sapo doli nga pallati, ishte edhe i martuar! Pozonte në rrjet me armë (FOTOT)
23 Gusht, 08:23



Operacion anti-kanabis në Pukë, pranë parcelës me drogë një person i armatosur! Largohet në terrenin e vështirë, policia qëllon në ajër
22 Gusht, 21:58



Neutralizohen zjarret në Gojan të Pukës, banorët e fshatit për Report Tv: Dje ka qenë situatë lufte! Mirë që nuk na u dogjën shtëpitë (VIDEO)
22 Gusht, 17:47



Zjarri në Gojan të Pukës, administratori apostolik i dioqezës së Sapës: Malet e Shqipërisë janë bërë shkrumb e hi nga pakujdesia (VIDEO)
22 Gusht, 13:32



Nis edicioni i 88-të i Superligës, Vllaznia dhe Skënderbeu barazojnë 2-2 në ndeshjen hapëse
21 Gusht, 23:13



Flakët në fshatin Gojan i Madh në Pukë, ministri Ermal Nufi për Report Tv: Sot në gjithë vendin kishim një situatë shumë të vështirë, por tani vatrat e zjarrit janë nën kontroll! (VIDEO)
21 Gusht, 20:42



Zjarret në Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes bën bilancin: 8 vatra aktive, situata më kritike në Pukë dhe Mirditë! 4 banesa të djegura në fshatin Gojan i Madh
21 Gusht, 18:12



Zjarri në Gojan të Madh të Pukës, Trajçe: Situatë alarmante, mund të digjen shtyllat e tensionit! Rrezikohet edhe shkolla e fshatit! Dëme të mëdha për biodiversitetin (VIDEO)
21 Gusht, 16:57



Pukë/ Zjarri në fshatin Gojan i Madh i afrohet banesave, situatë kaotike në lagjen Pepaj! Evakuohen banorët
21 Gusht, 15:27

Lajmi i fundit



**Kriza në Kosovë/ PDK nuk heq dorë, i dërgon sërish letër Deharit: Të hënën në 11:00 deputetët do të jenë në sallë**
23 Gusht, 22:54



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit

Kriza në Kosovë/ PDK nuk heq dorë, i dërgon sërish letër Deharit: Të hënën në 11:00 deputetët do të jenë në sallë
23 Gusht, 22:54